



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 23, datë 31.01.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEK SIN NR. 2, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1032, RRUGA “ALEKS KOMNENI” DHE PALLATIN “KASTRATI”, RRUGA “RAMADAN VELIU”, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, DUKE PËRFSHIRË Z. HYSEN JONUZI**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”; Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr. 1032, Rruga “Aleks Komneni” dhe Pallatin “Kastrati”, Rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”; Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 i ndryshuar, të kryetares së bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit

të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e një shtese në Aneksin nr. 2, “Pallati nr. 1032, Rruga “Aleks Komneni”, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr. 1032, Rruga “Aleks Komneni” dhe Pallatin “Kastrati”, Rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr. 2, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021, përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Hysen Jonuzi në masën e strukturës së njësisë së banimit 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5, bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 02.02.2023**



09/02/23 273/S

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 85/prot.  
11

Durrës, më 09.02.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.23 datë 31.01.2023 “Për miratimin e një shtese në Aneksin nr 2, të VKB nr 30 dt 26.03.2021 “ Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 1032, Rruga “Aleksa Komneni” dhe pallatin “Kastrati”, Rruga “Ramadan Veliu” të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019” duke përfshirë Z.Hysen Jonuzi”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

